



Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

**Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale
28 Maj 2014 - 06 Qershor 2014**

Përmbajtja

Raport i Auditorëve te pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare	6
Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve	7
Informata te përgjithshme	8
Shënime për Pasqyrat Financiare te Fushatës	Error! Bookmark not defined.

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së PDAK-së

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PDAK” apo “SP”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 28 Maj 2014 deri me 6 Qershor 2014, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 6-10.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Subjekti politik nuk ka dorëzuar shënime mbi asetet, detyrimet dhe ekuitetin e SP me 06 Qershor 2014 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse asetet, detyrimet dhe ekuiteti i deklaruar pasqyrojnë drejt gjendjen SP në këtë datë raportuese.
- SP ka paguar paga dhe kompensime në vlerë prej 1,150 Euro ,por që nuk janë përlllogaritur dhe deklaruar tatimet dhe kontributet si tatim në burim bazuar në Ligjin nr.03/L-161 për Tatim në të Ardhura Personale sipas kërkesës nga neni 6 dhe 7 i Ligjit.
- Nga shpenzimet e raportuara në vlerë prej 3,718 Euro ne shënimin 2, ne kemi konstatuar qe shpenzimet në vlerë 1,380 Euro nuk janë të mbështetura me evidencën kontabël si dhe me dokumentacionin tjetër mbështetës .
- Gjatë auditimit ton ne kemi vërejtur qe SP nuk ka prezantuar gjendjen e parasë dhe ekuivalenteve te parasë në fillim dhe në funde të periudhës raportues, kjo ka ndikuar ne një prezantim jo real te aseteve te SP dhe një prezantim jo korrekt te gjendjes financiare me këtë datë.

Theksim i çështjes

Pa dashur ta ndryshojmë opinionin, ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e më poshtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të

arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë.

Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë.

Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fadil Hyseni
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Bilanci ne fundë	Bilanci në fillim
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata			
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë			
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra			
Total pasuritë			
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			
Suficiti / (deficiti) i vitit			
Total Ekuiteti			
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera			
Detyrimet tjera afatshkurtra			
Gjithsej detyrimet afatshkurtra			
Gjithsej detyrimet			
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet			

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	28 Maj 2014 – 06 Qershor 2014
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		3,718
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla		
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		
Të hyrat tjera		
Gjithsej të hyrat për vitin		3,718
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet	2	1,150
Shpenzimet e transportit	2	757
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2	1,518
Blerja e mallrave	2	
Shpenzimet e përgjithshme	2	293
Shpenzimet e ndryshme	2	6.00
Gjithsej shpenzimet për vitin		3,718
Suficiti / (deficiti) për vitin		-

1. Informata të përgjithshme

Emri i plotë i subjektit është Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (si më tej SP “PDAK”) me seli në Adresën: Rruga ”Vudrov Wilson”, pn Ferizaj. Pasqyrat financiare të SP PDAK janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Subjekti politik është person juridik jo fitimprurës me NF 600535845.

Kryetar i Partisë është Danush Ademi. Llogaria bankare është e hapur në PCB.

Burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike përbëhen nga kontributet si:

1. Financimi nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
2. çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (më tej si “PDAK”);
3. Të ardhurat nga aktivitetet e subjektit politik të përcaktuara me nenin 6 të ligjit LFSP.

Qëllimi i përdorimit të mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Mjetet nga Fondi mund të përdoren për këto qëllime:
 - 1.1. Financimi i aktiviteteve të subjekteve politike;
 - 1.2. Financimi i degëve të subjekteve politike;
 - 1.3. Për shpenzime materiale vjetore të deputetëve dhe punën e Grupeve Parlamentare për aktivitete partiake;
 - 1.4. Për shpenzime për zgjedhjet lokale dhe qendrore, dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të subjekteve politike.

Shënimi 3: Shpenzimet

	Shpenzimi	Pagesa	Borxhi i mbetur
Shpenzimet	në Euro	në Euro	në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	1,150	1,150	
Pagesat e vëzhguesve			
Kontributet pensionale të punëmarrësit			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera			
Gjithsej	1,150	1,150	
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			
Karburantet	277	277	
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit	480	480	
Gjithsej shpenzimet e transportit	757	757	
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	520	520	
Ushqimi	97	97	
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive			
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	900	900	
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	1,517	1,517	
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës			

Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës
 Shënime për Pasqyrat Financiare te Fushatës
 Zgjedhjet nacionale 28 Maj 2014 deri më 6 Qershor, 2014

Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave			
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	293	293	
Telefoni, interneti dhe posta			
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	293	293	
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			
Gjithsej shpenzimet e ndryshme			
Gjithsej shpenzimet	3,717	3,717	